

# Çfarë mund të bëjnë banorët e Nju-Jorkut për të kufizuar përhapjen e koronavirusit



Përveç nëse jeni i sëmurë rëndë, shmangni paraqitjen në sallën e urgjencës apo në zyrën e mjekut, për të kufizuar ekspozimin e pacientëve të tjerë dhe të personelit mjekësor. Nëse ndiheni i sëmurë, qëndroni në shtëpi dhe telefonojini ofruesit tuaj të kujdesit shëndetësor.



Nëse keni simptoma për mbi 3 apo 4 ditë, telefonojini 311 për këshillim të menjëhershëm. Nëse është nevoja, do të lidheni me personelin mjekësor që do t'ju ndihmojë të përcaktoni nëse duhet të merrni trajtim, apo të kryeni analizën apo nëse duhet të qëndroni në shtëpi dhe të vijoni së monitoruari simptomat për të parandaluar ekspozimin ndaj të tjerëve.



Nëse mund të keni rënë në kontakt me një person tjetër që është i sëmurë, do t'ju kërkohet të vetizoloheni ose të planifikoni një orar për vlerësimin apo analiza të mëtejshme. Shumica e rasteve me virusin paraqesin simptoma të lehta dhe mesatare të etheve dhe të kollës, dhe mund të administrohen në mënyrë të sigurt në shtëpi.



Telefonojini 911 nëse keni vështirësi me frymëmarrjen apo ndonjë simptomë tjetër që kërkon kujdes të menjëhershëm mjekësor.